



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

RRJEDHA E PROCESIMIT- PUNIMI MASTER

Kandidati e parashtron kërkesën për shqyrtimin e propozimit të punimit të diplomës master në Departamentin përkatës sipas formularit F1 përmes shërbimit të studentëve. Studenti e dërgon edhe verzionin elektronik të projektit në shërbim të studentëve.
Përshtatshmëria shqyrtohet në Departament në afat prej 30 ditësh.
Departamenti i propozon Këshillit miratimin e propozimit dhe emërimin e Komisionit për Vlerësim. Këshilli miraton propozimin për temë dhe emëron Komisionin për Vlerësim.

F1

HAPI 1 NË PROCES

Të paktën tre muaj pas datës së vendimit të Këshillit të Fakultetit për miratim të projektpropozimit të punimit master, kandidati, pasi ta ketë përfunduar punimin dhe pas miratimit të mentorit, mund të paraqesë kërkesën për vlerësimin e dorëshkrimit të punimit të diplomës, sipas Formularit F2.
Kërkesa e protokoluar, bashkë me tri kopje të buta të punimit të diplomës, drëzohet në shërbim të studentëve. Punimi i bashkangjitet edhe Deklarata e Studentit për punë autentike.

F2

Deklarata

HAPI 2 NË PROCES

Pasi të pranojë kërkesën dhe kopjet e temës, Komisioni përpilon raportin e vlerësimit të punimit mastër sipas formularit F3.
Në mbledhjen e radhës të departamentit, komisioni paraqet raportin e vlerësimit. Raporti diskutohet në departament dhe nëse aprovohet, shpallet diskutimi publik. Abstrakti i punimit qëndron në uebfaqe/tabelat e shpalljes për studentë së paku 5 ditë para mbledhjes së Këshillit, kur edhe aprovohet tema për mbrojtje.

F3

HAPI 3 NË PROCES

Pas adresimit të komenteve nga diskutimi publik, shkresa e udhëheqësit të departamentit, së bashku me raportin e vlerësimit nga Komisioni i përcillet Këshillit të Fakultetit.
Këshilli në mbledhjen e radhës merr vendim për aprovim të raportit dhe emëron Komisionin për mbrojtje publike.

HAPI 4 NË PROCES

Komisioni për Mbrojtje nuk mund të organizojë mbrojtjen publike së paku 7 ditë nga dita kur i merr vendimet Këshilli. Pas kësaj, mund të shpallet mbrojtja publike.
Komisioni obligohet ta plotësojë Formularin F4 për mbrojtje të punimit.
Kandidati, pasi të marrë për bazë sugjerimet e fundit të komisionit, i bën përmirësimet e kërkuara dhe e printon në 5 kopje me kopertina të forta sipas standardit të përcaktuar nga Fakulteti. Punimi i diplomës protokolohehet dhe dorëzohet në shërbim të studentëve.

F4

HAPI 5 NË PROCES

VËREJTJE: Kandidatët duhet të paraqiten në shërbimin studentor për të kompletuar dosjen para shpalljes së mbrojtjes së punimit Master.
Administrata verifikon dosjen e kandidatit dhe plotësimin e kriterëve për diplomim. Pas verifikimit, administrata njofton me shkrim mentorin që dosja është e kompletuar dhe e verifikuar. Pas pranimit të këtij emaili, mentori e dërgon njoftimin për shpallje të mbrojtjes publike tek shërbimi i TI-së. Ky i fundit e publikon në webfaqen e Fakultetit.

KOMPLETIMI I DOKUMENTACIONIT NË DOSJE